

VENDIM
Nr.514, datë 6.7.2011

PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQES NË NGASTRAT E EKONOMISË PYJORE LUGINA E FANIT TË VOGËL, MIRDITË, QË DO TË PËRDOREN NGA SHOQËRIA “PRENDI-02” SHPK, PËR USHTRIM VEPRIMTARIE MINERARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjës “b”, të pikës 1 të nenit 17 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Sipërfaqet në ngastrat 54/a, 55/a dhe 56/a të ekonomisë pyjore lugina e Fanit të Vogël, Mirditë, gjithsej 9.568 (nëntë pikë pesëqind e gjashtëdhjetë e tetë) ha, që do të përdoret nga shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., për shfrytëzimin me karrierë të objektit të bazaltëve, të hiqen nga fondi pyjor dhe Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave, sipas tabelës 1 dhe hartës përkatëse që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, pasi të përcaktohen në terren dhe në hartë kufijtë e rinj të fondit pyjor kombëtar, që rezultojnë nga heqja e sipërfaqeve të këtyre ngastrave, sipas pikës 1 të këtij vendimi, bën çregjistrimin e saj nga kategoria “Tokë e zënë, pyll” dhe e regjistron në “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi me karrierë të bazaltëve”, sipas kushteve të projektit të parashtruar dhe planimetrisë bashkëlidhur, në përputhje me vendimin nr.1353, datë 10.10.2008 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor”.

3. Sipërfaqja e mësipërme të regjistrohet në kadastrën minerare, në administrim të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, pronësi publike.

4. Shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., të paguajë, për sipërfaqen që hiqet nga fondi pyjor si pasojë e ushtrimit të veprimtarive të parashikuara, tarifat e llogaritura sipas lidhjes nr.4 të vendimit nr.391, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe kullotave”, të ndryshuar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., të pyllëzojë me fondet e veta, brenda 2 (dy) viteve, 10 (dhjetë) ha fond pyjor, në ngastrat e përcaktuara nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor. Lloji i drurëve që do të mbillen dhe grafiku i mbjelljeve caktohen nga drejtoria përkatëse e shërbimit pyjor, e cila ndjek mbjelljet deri në marrjen në dorëzim me procesverbal të sipërfaqes së pyllëzuar, sipas marrëveshjes që do të lidhë me kërkuesin.

6. Me përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në planin e rehabilitimit të sipërfaqes nga shoqëria “Prendi-02” sh.p.k., sipërfaqja e rehabilituar në pyll të hiqet nga kadastra minerare dhe të reregjistrohet fond pyjor.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha